




Apoteozë e paimitueshmërisë: Një analizë strukturore e sures El-Keuther

Description

Fakhrudin el-Razi

Surja el-Keuther ka tre ajete dhe është mekase.

Edhe pse është një sure e shkurtër ajo fsheh shumë urtësi:

E para: Kjo sure ka një qasje krejt të kundërt me suren e mëparshme, sepse në suren pararendëse Allahu tregon katër cilësi të hipokritëve, të cilat janë:

1. Këtë gjë e vëmë re në ajetin 2 dhe 3 të sures el-Maun: **“Ai dëbon jetimin”** dhe **“nuk nxit t'i jepet ushqim të varfërit”**.
2. Lënia e namazit. Këtë gjë e konstatojmë në ajetin 5 në po të njëjtën sure: **“janë të pakujdesshëm për namazet”**
3. Syefaqësia gjatë faljes. Në ajetin 6 në po të njëjtën sure Allahu thotë: **“të cilët duan vetëm që të duken”**.
4. Refuzimi i dhënies së zeqatit. Kjo gjë konstatohet në ajetin e fundit të sures el-Maun: **“dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve”**

Për këtë arsye në suren el-Keuther Zoti përmend katër virtyte të larta përkundër katër tipareve të hipokritëve. Kështu që në vend të koprracisë Allahu shpalli ajetin: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty el-Keutherin”**, që do të thotë shumë të mira, prandaj edhe ti jepu njerëzve dhe mos u bëj koprrac. Ndërsa në përgjigje të **“janë të pakujdesshëm për namazet”**, Allahu shpalli **“andaj, falu”**, pra fale rregullisht namazin. Ndërsa në përgjigje të ajetit **“të cilët duan vetëm që të duken”**, Allahu shpalli ajetin **“për Zotin tënd”**, që do të thotë fale namazin për kënaqësinë e Zotit tend dhe jo për sytë e njerëzve. Në fund, në përgjigje të ajetit **“dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve”**, Allahu shpalli ajetin **“dhe ther kurban”**, që do të thotë mishin e kurbanit ndaje me të tjerët.

Ekziston një harmonie e jashtëzakonshme mes dy sureve, ndërsa në përfundim të sures el-Keuther Allahu thotë: **“Sigurisht, ai që të urren ty, vetë është farësosur”**, pra ky hipokrit që ka këto tipare të

cilat Zoti i përmend në suren el-Maun, dhe që sillet në këtë mënyrë kaq të shëmtuar, do të vdesë një ditë dhe nuk do të lërë as nam as nishan, ndërsa fama jote do të kujtohet gjithmonë sa të jetë jeta, ndërsa në Botën Tjetër do të shpërblehesh pa masë.

E dyta: Një tjetër dobi e jashtëzakonshme e kësaj sure është trajtesa e tre niveleve të udhëtimit shpirtëror:

Niveli i parë: Kridhja me mish e me shpirt në dritën e madhështisë së Zotit, ky është edhe niveli më i lartë.

Niveli i dytë: Përkushtimi në adhurime fizike.

Niveli i tretë: Frenimi i shpirtit të mos derdhet pas kënaqësive fizike dhe pasioneve tokësore.

Në këtë kontekst fjala e Allahut: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty el-Keutherin”** referon tek niveli i parë që në fakt tregon se shpirti i tij i pastër dallon nga të gjithë shpirtrat e njerëzve të tjerë si për nga madhësia ashtu edhe cilësia.

Dallon për nga madhësia sepse përfshin më shumë vizione, por edhe për nga cilësia sepse një shpirt i tillë është i prirur t'i shndërrojë këto vizione në akte dhe t'i shfrytëzojë ato.

Ajeti **“andaj falu për Zotin tënd”** jep indicie për nivelin e dytë, ndërsa pjesa e mbetur prej tij **“dhe ther kurban”** për nivelin e tretë, sepse vetëpërmbajtja prej kënaqësive të përkohshme i jep fund egos njësoj si kurban i kafshës.

“Sigurisht, ai që të urren ty, vetë është farësosur” që do të thotë se shpirti që të shtyn pas kënaqësive biologjike dhe pasioneve futet në një rreth vicioz që të çon drejt zhdukjes, por veprat e mira që mbesin, janë të shpërblyera më mirë tek Zoti yt, dhe kulmojnë me lumturinë shpirtërore dhe njohjen hyjnore të cilat janë të përjetshme.

Le të marrim të komentojmë këtë sure të jashtëzakonshme tani.

Allahu i madhëruar thotë: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty el-Keutherin”**, nga ky ajet kuranor nxjerrim disa dobi:

Dobia e parë: Le të themi se kjo sure plotëson kuptimin e sureve të mëparshme dhe hedh bazat për suret në vijim. Mund ta shohim në këtë këndvështrim, pra si plotësuese e sureve të mëparshme duke marrë parasysh faktin se surja el-Duha ka si specifikë lavdet për Muhamedin (a.s), sepse aty Zoti merr të tregojë etapat e jetës së tij, dhe në krye të saj Zoti përmend tre çështje kryesore që lidhen me profecinë:

E para: **“se Zoti yt nuk të ka braktisur e as nuk të urren (o Muhamed)”** (Surja el-Duha:3)

E dyta: **“Natyrisht, jeta e ardhshme për ty është më e mirë se kjo jetë”** (Surja el-Duha:4)

E treta: **“e, sigurisht që Zoti yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur.”** (Surja el-Duha:5)

Pastaj Zoti e mbyll këtë sure duke vënë në dukje tre etapa të jetës së Profetit që lidhen me hallet e kësaj bote.

1. **“A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë?”** (Surja el-Duha:6)
2. **“A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi?”** (Surja el-Duha:7)
3. **“A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kesh nevojën askujt?”** (Surja el-Duha:8)

Ndërsa në suren el-Sherh Allahu tregon sesi e ka nderuar Muhamedin me tre gjëra:

1. **“Vallë, a nuk ta hapëm ty (Muhamed) kraharorin (për të pranuar besimin).”** (Surja el-Sherh:1)
2. **“dhe ta hoqëm barrën, e cila ta rëndonte tepër kurrizin.”** (Surja el-Sherh:2-3)
3. **“dhe ta lartësuam emrin.”** (Surja el-Sherh:4)

Kurse në suren el-Tin e nderon Muhamedin në tri mënyra:

E para: Betohet për qytetin e tij: **“dhe për këtë Qytet të sigurt (Mekën)”** (Surja el-Tin:3)

E dyta: Ymeti i tij do të shpëtojë prej zjarrit: **“përveç atyre që besojnë”** (Surja el-Tin:6)

E treta: Ata do ta përfitojnë shpërblimin: **“ata do të kenë shpërblime të pandërprera.”** (Surja el-Tin:6)

Në suren el-Alak Zoti e nderon Muhamedin në tri mënyra:

E para: **“Lexo me emrin e Zotit tënd”** (Surja el-Alak:1), pra lexoje siç duhet Kuranin dhe kërko ndihmë prej Zotit tënd.

E dyta: Zoti e mposhti kundërshtarin e tij **“Atëherë ai le ta thërrasë shoqërinë e vet, Ne do t'i thërrasim Zebanijet (rojet e Xhehenemit).”** (Surja el-Alak:18)

E treta: Zoti i rezervon Muhamedit një vend të veçantë **“bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!”** (Surja el-Alak:19)

Ndërsa në suren el-Kader Zoti e nderon Muhamedin me Natën e Kadrit e cila ka tri veçori:

E para: Ajo natë është **“më e mirë se një mijë muaj.”** (Surja el-Kader:3)

E dyta: Atë natë zbresin **“engjëjt dhe shpirti (Xhebraili).”** (Surja el-Kader:4)

E treta: Ajo natë është **“page është ajo deri në shkrepjen e agimit.”** (Surja el-Kader:5)

Në suren el-Bejine Zoti e nderon umetin e Muhamedit me tri gjëra:

E para: Ata janë **“krijesat më të mira”** (Surja el-Bejine:7)

E dyta: **“Shpërblimi për ta është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit.”** (Surja el-Bejine:8)

E treta: **“Allahu është i kënaqur me ta.”** (Surja el-Bejine:8)

Në suren el-Zelzele Zoti e nderon Muhamedin me tri gjëra:

E para: **“Atë ditë ajo do të tregojë lajmet e saj.”** (Surja el-Zelzele:4), që do të thotë se toka do të dëshmojë për ibadetin dhe devocionin e umetit të Muhamedit Ditën e Gjykimit.

E dyta: **“Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre.”** (Surja el-Zelzele:6), kjo do të thotë se adhurimet e besimtarëve do të ekspozohen atë ditë gjë që do t’i gëzojë ata pa masë.

E treta: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.”** (Surja el-Zelzele:7). Nuk ka asnjë dyshim se dija e Zotit është më e madhe se çdo gjë sado e madhe të jetë ajo, kështu që besimtarët do ta arrijnë patjetër shpërblimin për çdo punë.

Dhe edhe në suren el-Adijat Zoti e nderon Muhamedin tek betohet në emër të kuajve të luftëtarëve të umetit të tij, të cilët i vlerëson për tri karakteristika:

1. **“Betohem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur.”**
2. **“që nxjerrin xixa nga thundrat”**
3. **“dhe trokojnë për sulm në mëngjes”** (surja el-Adijat 1-3)

Po edhe në suren el-Karia e nderon umetin e tij në tri mënyra:

E para: **“Sa i përket atij veprat e të cilit do të rëndojnë në peshore.”** (Surja el-Karia: 6)

E dyta: **“ai do të ketë një jetë të kënaqur.”** (Surja el-Karia: 7)

E treta: Ata do t’i shikojnë armiqt e tyre në **“Zjarrin e vrullshëm.”** (Surja el-Karia: 11)

Pastaj Zoti e nderon atë në suren el-Tekathur duke sqaruar se ata që refuzojnë fenë dhe ligjin e tij do të ndëshkohen në tri forma:

E para: Ata do ta shohin xhehenemin.

E dyta: Do ta shohin me syrin e sigurisë.

E treta: Dhe do të merren në llogari për begatitë.

Ndërsa në suren el-Asër e nderon umetin e tij me tri gjëra:

E para: Besimi **“përveç atyre që besojnë”**

E dyta: Vepra **“dhe bëjnë vepra të mira”**

E treta: Orientimi i njerëzve drejt veprave të mira, pra **“ata i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën dhe i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** (Surja el-Asër:2-4)

Ndërsa në suren el-Humeze e nderon duke treguar se kush shpif dhe përqesh do të ndëshkohet në tri mënyra:

E para: Ai nuk do të ketë asnjë dobi nga ajo që ka fituar në këtë jetë **“mendon se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm.”** (Surja el-Humeze:3)

E dyta: **“Në të vërtetë ai do të hidhet në torturën dërmuese.”** (Surja el-Humeze:4)

E treta: Dhe do t’ia mbyllë dyert që të mos ketë asnjë shpresë për të dalë që aty **“Ai do t’i rrethojë ata nga çdo anë.”** (Surja el-Humeze:8)

Ndërsa në suren el-Fil Zoti e nderon Muhamedin duke i kujtuar sesi ia prishi atyre komplotin me tre elementë:

E para: **“ua prishi atyre kurthin”**

E dyta **“duke dërguar kundra tyre tufa zogjsh”**

E treta: **“dhe kështu i bëri si byk i ngrënë”** (Surja el-Fil: 2-5)

Në suren el-Kurejsh Zoti e nderon Muhamedin në tri mënyra duke i kujtuar sesi ai i ka mbrojtur interesat e paraardhësve të tij:

E para: I bashkoi dhe unifikoi ata **“për sigurinë e Kurejshëve”**

E dyta: **“I ushqeu ata në ditë urie”**

E treta: **“dhe i siguroi në ditë frike”** (Surja el-Kurejsh: 1-4)

Ndërsa në suren el-Maun Zoti e nderon Muhamedin po ashtu në tri forma duke vënë në dukje tiparet e përgënjeshtresve të fesë së tij:

E para: Poshtërimi dhe qortimi **“dëbon ashpër jetimin”** dhe **“nuk nxit t’i jepet ushqim të varfërit”.**

E dyta: Heqja dorë prej të madhëruarit Zotin **“janë të pakujdesshëm për namazet”** dhe **“duan vetëm që të duken”**

E treta: Refuzimi i ndihmës së njerëzve **“dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve”** (Surja el-Maun:2-7)

Dhe vetëm pasi e nderon në kaq shumë mënyra të dërguarin e tij Zoti thotë: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, pra Ne të kemi dhënë kaq shumë të mira, të cilat t’i vumë në dukje në suret e mëparshme, ku në fakt secila prej tyre vlen më shumë se kjo botë dhe çfarë përfshin ajo, prandaj përkushtohu në adhurim dhe orientoji njerëzit në punë të dobishme.

Adhurimi mund të kryhet ose fizikisht **“falu për Zotin tënd”**, ose materialisht **“dhe ther Kurban”**, ndërsa orientimi i njerëzve drejt veprave të dobishme në të dy botët vihet re në fjalën e Allahut : **“Thuaj: O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuronit.”** (Surja el-Kafirun:1-2).

Sa kaq kuptojmë se kjo sure është në harmoni të plotë me suret e mëparshme dhe e plotëson panoramën si dhe hedh themelet për kuptimin e sureve në vijim. Sa i takon kësaj të fundit, pra faktit se kjo sure hedh gurë themelin për kuptimin e sureve në vijim, kjo kuptohet nga fakti se Zoti i jep urdhër atij për të shpallur pabesimtar çdo njeri të gjallë në kohën e tij: **“Thuaj: O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuronit”.**

Ne e dimë tashmë se njerëzit janë më fanatikë për ideologjinë dhe fenë e tyre sesa për jetën dhe pasurinë, sepse ata këto të fundit i vënë në shërbim të fesë së tyre, dhe madje s'ka asnjë dyshim se refuzimi i fesë ngjall armiqësi dhe zemërim më shumë se ç'mund të provokojë çdo gjë tjetër.

Pasi Allahu e urdhëron atë t'i shpallë pabesimtarë të gjithë banorët e tokës, duke i dekonstruktuar fetë e tyre në themel, me siguri që kjo sjellje do të ngjallte armiqësi të paparë, dhe kjo është arsye e mjaftueshme për të kuptuar se përse njerëzit shmangen dhe gati askush nuk guxon ta marrë përsipër një mision të tillë. Mjafton të kujtojmë rastin e Musait a.s dhe sesa frikësohej ai prej Faraonit dhe ushtrisë së tij, ndërsa rasti i Muhamedit a.s, duke qenë se ai u dërgua profet për të gjithë njerëzimin është edhe më i ndërlikuar, dhe në këtë kuptim çdo anëtarë i shoqërisë së tij shndërrohet në një faraon potencial përballë tij, kështu që për ta larguar frikën permanente nga zemra e Muhamedit, Allahu shpalli një plan domethënës, dhe suren el-Kafirun e parapriu me suren el-Keuther: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**.

Kjo gjë do të bënte të mundur largimin e frikës prej tij për disa arsye:

E para: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** që do të thotë të mira të shumta në këtë jetë dhe në jetën e përtejme, pra një premtim prej Zotit që i garanton Muhamedit fitore dhe mbrojtje, një ajet tjetër i ngjashëm është edhe: **“O Profet! Allahu të mjafton ty”** (Surja el-Enfal:64), ose **“Allahu të ruan ty prej njerëzve”** (surja el-Maide:67), ose **“Nëse ju nuk e ndihmoni atë (Muhamedin a.s.), Allahu tashmë e ka ndihmuar”** (Surja el-Teube:40), dhe kë e merr Zoti në mbrojtje nuk ka pse të frikësohet prej askujt.

E dyta: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** kjo përfshin të mirat e dy botëve, por me qenë se Muhamedi gjatë periudhës mekase nuk i kishte shijuar ende të mirat e Zotit, për arsye që dihen, Ai i dha jetëgjatësi atij në mënyrë që t'i shijojë ato. Sepse ne e dimë që mosmbajtja e premtimit nuk është sjellje hyjnore dhe për Zotin është e pavend një gjë e tillë. Ky nuk është vetëm një sihariq, por edhe një premtim në të njëjtën kohë, që do të thotë se ata as nuk mund ta eliminojnë dot Muhamedin (a.s), as nuk mund ta nënshtrojnë dhe as t'i bëjnë komplot, përkundrazi ai çdo ditë e më shumë do të bëhet më i fuqishëm.

E treta: Pasi profeti a.s dekonstrukttoi fenë e tyre dhe mbajti qëndrim duke i konsideruar pabesimtarë, i ftoi të besojnë vetëm një Zot, por ata u mbloodhën dhe vendosën t'i bëjnë një ofertë. Në qoftë se këtë gjë e bën sepse kërkon të jesh i pasur, të japim pasuri sa të bëhesh njeriu më i pasur mes nesh, në qoftë se e bën këtë gjë për arsye se kërkon të martohesh, të martojmë me vajzën më të bukur që kemi, dhe në qoftë se e bën këtë gjë sepse lakmon të jesh i pari ynë të bëjmë menjëherë kryetarin tonë, por Allahu shpalli ajetin **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, që do të thotë, për sa kohë që Krijuesi i qiejve dhe i tokës të jep të mira pa fund mos u josh prej ofertës së tyre.

E katërta: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** nënkupton se Allahu ka folur me të pa ndërmjetësues, gjë që tregon se ai gëzon një pozitë po aq të lartë sa Musai, sepse **“Allahu i ka folur Musait drejtpërdrejt”** (Surja el-Nisa:164), madje Muhamedi qëndron në pozita edhe më të larta se ai, sepse një zotëri që komunikon me shërbyesin e tij në kushtet e respektit dhe dashamirësisë, tregon se kjo sjellje është më fisnike se të komunikojë në kushte të tjera, dhe kjo natyrë komunikimi e qetëson zemrën dhe eviton frikën, gjë që konfirmon se komunikimi i Zotit me të përmes ajetit **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** është mundësi për të evituar frikën nga zemra e tij dhe për këtë arsye Allahu e rendit këtë sure para **“Thuaj: O ju jobesimtarë!”**, në mënyrë që Muhamedi t'i përkushtohet kësaj detyre të mundimshme, nisur me tekfirin e mbarë shoqërisë dhe deklamimin e refuzimit të

idhujve. Dhe vetëm pasi të kryesh këtë gjë, pra pasi të zbatosh urdhërin Tim do të shikosh sesi Unë e mbaj premtimin duke të dhënë shumë pasues dhe ithtarë, dhe njerëzit do të përqafojnë fenë e Zotit grupe-grupe.

Dhe kur daveti bëhet fakt dhe çështje publike Zoti merr të na tregojë nivelet e jetës shpirtërore. Kjo gjë është e arsyeshme në fakt, sepse njeriu ose rend veç pas të mirave të kësaj bote, ose rend pas jetës së përtejme. Kush rend veç pas kësaj bote si shpërblim do të marrë dështimin, poshtërimin dhe përbuzjen, dhe do të përfundojë në zjarr, pikërisht këtë kuptim ka edhe surja el-Mesed. Ndërsa ai që rend pas Botës Tjetër gjendja e tij më e lartë shpirtërore përfaqësohet nga një shpirt i lartë që shndërrohet në një pasqyrë ku janë gdhendur imazhet e ekzistencave. Është e njohur për shkencat racionale se mundësitë e njeriut për të njohur krijuesin janë dy:

Kategoria e parë përfshin atë grup njerëzish të cilët përmes njohjes së Krijuesit marrin të njohin krijesat, ky është edhe niveli më i lartë i njohjes, por ekziston edhe një kategori tjetër, krejt e kundërt, që përfaqëson edhe nivelin e masës.

Allahu merr ta mbyllë librin e Tij Fisnik pikërisht me këtë mënyrë që është edhe niveli më i lartë mes dy niveleve. Ai fillon të përmendë atributet e larta të Zotit dhe një koment mbi Madhësitinë e Tij në suren **“Thuaj: Ai është Allahu, Një i Vetëm”** (Surja el-Ihlas: 1). Pastaj në suren **“Thuaj: Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit”** merr të sqarojë nivelet e krijesave, dhe e mbyll librin me nivelet e gjendjes shpirtërore të njeriut. Këtë të fundit do ta sqaroj me detaje kur të komentoj suren në fjalë. Lavdi qoftë Zotit që mendjen e njeriut e orientoi të zbulojë këto sekrete në Librin e Tij Fisnik!

Dobia e dytë: Në ajetin kuranor **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** përemri vetor *Ne* ka dy përdorime: një herë përdoret thjesht si përemër vetor në numrin shumës, dhe një herë si përemër vetor në numrin shumës por edhe me një ngarkesë pushteti dhe madhësie.

Përdorimi i përemrit vetor në rastin e parë përfaqëson monoteizmin, pra të qenurit e Zotit një, në këtë kuptim përemri në fjalë është i papranueshëm në numrin shumës, vetëm nëse do të pranohet se për këtë dhuratë të madhe kanë dhënë kontribut edhe engjëjt, Xhebraili, Mikaili dhe profetët e mëhershëm. Kujto rastin e Ibrahimit tek u lut **“O Zoti ynë! Dërgo tek ata një të dërguar nga gjiri i tyre”** (Surja el-Bekare:129), ndërsa Musai tha: **“O Zot më bëj pjestar të umetit të Ahmedit”**. Kjo gjë dëshmohej edhe në fjalën e Allahut **“Ti (o Muhamed) nuk ke qenë i pranishëm në anën perëndimore (të Turit), kur Ne ia besuam Musait Misionin (Profecinë) dhe as nuk ke qenë dëshmitar i kësaj ngjarjeje.”** (Surja el-Kasas:44). Madje një lajm kaq të mirë e dha edhe vetë Isai a.s **“dhe për t’ju sjellë lajmin e gëzueshëm për një të dërguar, emri i të cilit është Ahmed”** (Surja el-Saf:6)

Përdorimi i dytë i përemrit vetor *Ne* vjen me kuptimin e madhësisë dhe pushtetit, dhe ky është një sinjal i qartë për peshën e madhe të kësaj dhurate, duke qenë se dhuruesi në këtë rast është vetë Allahu, i Gjithëpushtetshmi i qiejve dhe i tokës. Këtë gjë e dëshmon edhe përemri vetor *ty* në fjalën e Allahut **“Ne të dhuruam ty”**, ndërsa dhurata për të cilën bëhet fjalë në këtë ajet është ajo që ne e quajmë el-Keuther që do të thotë të mira të shumta. Përemri në fjalë shpreh madhësitinë e Dhuruesit, dhuratës dhe të dhuruarit. E ku ka bekim dhe nderim më të madh se ky?!

Dobia e tretë: Dhurata edhe nëse është e rëndomtë, mjafton që është prej Dhuruesit të Madh për t’u konsideruar si një dhuratë e veçantë. Le të themi në qoftë se një mbret në shenjë respekti i dhuron skllëvërve të tij nga një mollë me siguri që ky veprim do të konsiderohej një nder i madh, jo për fakin se është një dhuratë e veçantë por për faktin se kush e dhuron. Edhe për rastin e el-Keutherit mund të

themi të njëjtën gjë, vërtetë ai mund të përfshijë shumë të mira, por duke patur parasysh se Ai që e dhuron është Mbreti i krijesave e bën atë edhe më të veçantë.

Dobia e katërt: Allahu i Madhëruar tek thotë **“Vërtet, Ne të kemi dhënë”**, e shoqëron me një provë e cila konfirmon se Ai nuk do të kërkojë rekurs të dhuratës, sepse sipas shkollës së Imam Ebu Hanifes dhuruesi ka të drejtë për rekurs, por nëse në këmbim të dhuratës merr diçka tjetër qoftë me një vlerë më të vogël atëherë e humb të drejtën për rekurs. Nëse përshembull një person dhuron diçka që vlen një mijë dollarë dhe në këmbim merr diçka që vlen një cent, e humb të drejtën për rekurs, për këtë arsye pasi Allahu thotë: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, kërkon prej Muhamedit të falet dhe të bëjë kurban, gjë që nënkupton heqjen e të drejtës ligjore për rekurs.

Dobia e pestë: Allahu e hap këtë sure me një kryefjalë të shprehur me përemër vetor (d.m.th. përemrin vetor ‘Ne’) gjë që jep siguri dhe garanci. Mjafton si dëshmi fakti se tek përmend emrin e tij, njeriut menjëherë i shkon mendja se për kë bëhet fjalë, kështu që mezi pret me mall të di se çfarë do të thotë, dhe sapo e njofton, njeriu pret të dëgjojë lajmin si ashiku të dashurën. Ky stil ligjërimor është kulminacioni i elokuencës dhe nuk lë asnjë mundësi për dyshim. Vetëm tani mund të kuptosh madhështinë e ligjërimit kuranor kur Allahu thotë: **“Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë”**, (surja el-Haxh:46) sepse ndryshe do të ishte nëse do të thoshte **“Në të vërtetë sytë e tyre nuk janë verbuar”**.

Një shembull që e konfirmon këtë që sapo thamë është edhe rasti i një mbreti të gjithëpushtetshëm i cili thotë unë do t’ju jap dhe do t’ju siguroj, dhe nëse premtimi është diçka me rëndësi nuk ka dyshim që ai do ta përmbushë duke patur parasysh madhështinë e mbretit, dhe kur bëhet fjalë për një person vërtet me peshë nuk ka vend për dyshim se ai mund ta shkelë premtimin e tij. I tillë është edhe ajeti i sures el-Keuther sepse ky i fundit është vërtetë një gjë e madhe, ndaj nuk mund të ketë tolerim në këtë pikë, prandaj Zoti e hap këtë ajet kuranor me një kryefjalë të shoqëruar me një përforcues **“Vërtetë Ne”**. Kësisoj paradigma në fjalë shndërrohet në një garanci për të eliminuar çdo dyshim dhe është një motiv për të mos hezituuar në vërtetësinë e saj.

Dobia e gjashtë: Allahu i Lartësuar në hapje të sures përdor një pjezës përforcuese (arab. ‘In’ = vërtet) e cila merr edhe kuptimin e një përbetimi, dhe ne e dimë se fjalët e Zotit janë të mbrojtura nga kontardikta, aq më tepër kur Ai e mbithekson një gjë të tillë?!

Dobia e shtatë: Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran: **“Vërtet, Ne të kemi dhënë”** dhe nuk thotë **“Ne do të japim”**, sepse struktura e ajetit në fjalë tregon se Allahu e ka dhënë tashmë atë dhuratë, dhe kjo formë e të shprehurit përfshin disa dobi:

1. Kush ka gëzuar një pozitë të lartë edhe në të shkuarën, gjithmonë i shtrenjtë, dhe me nevoja të plotësuar, është më i nderuar se ai që do të bëhet i tillë në të ardhmen. Prandaj profeti a.s thotë: **“Unë qesh përcaktuar profet ndërkohë që Ademi ishte mes ujit dhe baltës.”**
2. Ky ajet është një tregues i qartë se paracaktimi i Zotit për lumturinë, mjerimin, pasurinë dhe varfërinë, nuk është një vendim që përcaktohet tani, përkundrazi ai është një vendim i marrë tashmë që në përjetësi.
3. Duket sikur Zoti po i thotë Muhamedit se, Ne ta kemi parapërgatitur terrenin dhe shkaqet për të qenë i lumtur para së të shfaqesh në univers, si mund ta neglizhojmë çështjen tënde pasi të krijiam dhe ti more të përkushtohesh në adhurim?!
4. Duket gjithashtu sikur Zoti do t’i thotë Muhamedit sërish se, Ne nuk të përzgjedhëm dhe nderuam për hatër të ibadetit tënd, përndryshe do të duhej të t’i jepnim këto të mira veç pasi të tregoje

qartazi bindje dhe nënshtrim, pra Ne të kemi zgjedhur sepse deshëm të të nderojmë dhe respektojmë, në këtë kuptim është dhe thënia e profetit Muhamed: **“E pranon kush e pranon jo për ndonjë arsye, dhe refuzon kush refuzon jo për ndonjë arsye.”**

Dobia e tetë: Allahu thotë: **“Ne të kemi dhënë ty”** dhe nuk thotë Ne i kemi dhënë të dërguarit, profetit, dijetarit apo adhuruesit, sepse një shprehje e tillë jep të kuptohet se dhurata në fjalë është bërë e mundur në saj të këtij atributi, por fakti që Allahu thotë **“Ne të kemi dhënë ty”** tregon se dhurata nuk ka qenë për arsye të ndonjë atributi por veç dëshira dhe përzgjedhja e Zotit, siç thotë Allahu në Kuran: **“Jemi Ne ata që ua ndajmë”** (Surja el-Zuhruf:32), dhe **“Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit”** (Surja el-Haxh:75).

Dobia e nëntë: Në fillim Allahu thotë: **“Ne të kemi dhënë ty”** pastaj vazhdon **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”**, gjë që tregon se suksesi dhe udhëzimi si dhuratë prej Zotit i paraprijnë bindjes tonë. Dhe padyshim që kështu do të ishte, sepse dhurata e Zotit është atribut i Tij, ndërsa bindja është atribut i yni, në këtë kuptim atribut i krijesës nuk mund të ketë ndikim mbi atributin e Krijuesit, e kundërta me siguri që po. Në të njëjtën logjikë thuhet se el-Vasiti ka thënë: “Unë nuk adhuroj një Zot të cilin e kënaq bindja ime ndërsa mosbindja e zemëron”. Që do të thotë se atributet e Zotit, pra Kënaqësia dhe Zemërimi janë të kahershme, ndarsa bindja dhe mosbindja e njeriut janë të origjinuara, dhe në këtë kuptim një atribut që ka një origjinë, pra një fillësë, nuk mund të ketë ndikim mbi një atribut që ekziston në përjetësi, përkundrazi fakti që Zoti është i kënaqur me njeriun e shtyn këtë të fundit drejt bindjes, të njëjtën gjë duhet të themi edhe kur bëhet fjalë për zemërimin dhe mosbindjen.

Dobia e dhjetë: Në ajetin: **“Ne të kemi dhënë të mira të shumta”** Allahu përdor foljen ??????? – *atajnake* që përfaqësohet nga një “ta” e fortë dhe nuk përdor foljen ?????? – *atejnake* që përfaqësohet nga një “ta” e butë, për dy arsye:

E para: ?????? – el’ijta (me “ta” të butë) përcakton një veprim që mund të jetë i detyrueshëm por mund të jetë edhe çështje preferencash, ndërsa në rastin e ?????? – *el-l’ta* (me “ta” të fortë) veprimi përcaktohet si çështje preferencash, pra **“Ne të kemi dhënë të mira të shumta”** do të thotë se këto mirësi të shumta; Islami, Kurani, Profecia, nami në të dy botët janë dhuratë, pra ato nuk i gëzon për ndonjë meritë të veçantë apo detyrim nga ana jonë. Kjo qasje është një sihariq i madh për dy arsye:

Arsyeja e parë: Bujari i Madh në qoftë se merr ta kultivojë një të mirë si një dhuratë nga ana e Tij me siguri që nuk lejon të dëmtohet ajo, por çdo ditë e më shumë merr të kujdeset për të.

Arsyeja e dytë: Në qoftë se shpërblimi në fjalë do të ishte kompensim për ndonjë meritë të caktuar, ai do të vlente sa merita në fjalë, dhe ne e dimë që veprat e njeriut kanë një cak, për rrjedhojë edhe shpërblimi do të ishte i kufizuar. Ndryshe kur bëhet fjalë për një shpërblim që buron nga dëshira e Allahut, bujaria e të cilit është e pakufizueshme, për rrjedhojë edhe shpërblimi i tij është i pakufizueshëm. Pra, ajeti në fjalë **“Ne të kemi dhënë të mira të shumta”** përderisa nënkupton se të mirat e shumta janë çështje preferencash dhe jo meritë e njeriut kjo tregon se ato veç shtohen dhe janë të përfjeshme.

Por nëse dikush pyet: Allahu në Kuran thotë: **“Ne të kemi dhënë shtatë vargje që përsëriten dhe Kuranin e madhërishëm.”** (Surja el-Hixhër:87), ne do t’i përgjigjemi në dy mënyra:

1. Në rastin e *el-l’ta* – ??????? dhurata ka efekt juridik të menjëhershëm, pra hyn menjëherë në

pronësi të personit që i dhurohet, sepse pronësia është shkak i mjaftueshëm për përveçimin e pasurisë. Mund të sjellim si argument fjalët e Sulejmanit të cilat i përmend Zoti në Kuran:

“O Zoti im, më dhuro pushtet” (Surja Sad:35), ndërsa Zoti iu përgjigj: **“Kjo është dhurata Jonë për ty, prandaj jep lirisht ose mos jep gjë prej saj”** (Surja Sad:39), ndërsa në rastin e el-ijta -??????? (me “ta” të butë) dhënia ose dhurata nuk ka domosdoshmërisht efekt juridik, prandaj Zoti thotë në Kuran: **“Ne të kemi dhënë”** (Surja el-Hixhër:87), që do të thotë se i dërguari i Zotit nuk ka të drejtë të fshehë asgjë prej tij.

2. Partneriteti në rastin e Kuranit lidhet vetëm me aspektin e informacionit që gjendet në të, gjë që nuk përbën ndonjë problem, ndryshe është çështja nëse bëhet fjalë për Lumin, partneriteti në këtë rast është në substancë dhe ky është një gabim.

E dyta: ??????? – është një shprehje më e përshtatshme në këtë kontekst sesa ??????? sepse ??????? mund të përdoret si për sasi të mëdha ashtu edhe për sasi të vogla, prandaj Allahu i madhëruar thotë në Kuran: **“dhe jep pak e pa qejf?” duke përdorur në këtë ajet fjalën ???????** (Surja el-Nexhm:34), ndërsa ??????? përdoret veç kur bëhet fjalë për diçka me rëndësi të veçantë. Allahu thotë në Kuran: **“Allahu i dha atij pushtetin”** (Surja el-Bekare:251), dhe **(Me të vërtetë, Ne i dhamë Daudit mirësi prej Nesh)** (Surja el-Sebe:10) dhe në të dy këto raste në Kuran përdor fjalën ???????. Edhe fjala – ??????el-atij që është derivat i fjalës ??????? në gjuhën arabe përdoret për rrëkenë e furishme, dhe në qoftë se sa thamë më lart është e vërtetë atëherë fjala e Zotit: **“Ne të kemi dhënë të mira të shumta”** tregon një nderim dhe respekt të veçantë për Muhamedit, gjë të cilën mund ta mbështesim mbi këto fakte:

1. El-Haud – (Hauzi) në fjalë është shumë i vogël dhe i parëndësishëm në raport me të mirat e shumta që Zoti ka rezervuar për ty në Botën Tjetër. Pra ky është një sihariq që paralajmëron për gjëra edhe më të mëdha se këto.
2. El-Keuther i referohet ujit, pra sikur Allahu ka dashur të thotë: Uji në këtë jetë nuk ka vlerën e ushqimit, e nëse uji do të jetë me bollëk, po të mirat e tjera si do të jenë?!
3. Begatia e ujit është ??????? – *el-l'ta* ndërsa begatia e xhenetit është ?????? – *el-ijta*.
4. Zoti sikur ka dashur t'i thotë Muhamedit: këto të mira që të kam dhënë edhe nëse janë të shumta për rastin tënd duhen konsideruar ??????? – *el-l'ta* jo ??????- *el-ijta*, sepse ti meriton shumë më tepër. Zakonisht ai që jep dhurata në qoftë se është i pushtetshëm, dhurata e tij sado e çmuar të jetë në raport me pushtetin dhe mundësitë e tij konsiderohet e rëndomtë, e njëjta gjë vlen edhe për këtë rast.
5. Në rastin e el-Keutherit Zoti përdor fjalën ??????? – *el-l'ta* me qenë se lidhet me jetën, ndërsa në rastin e Kuranit përdor fjalën ?????? – *el-ijta* me qenë se lidhet me fenë.
6. Çdo të mirë që ke përfutur prej Meje është dhuratë ??????? – *el-l'ta* edhe në qoftë se është me bollëk, por më e rëndësishme se kjo është të mbetesh gjithmonë ngadhënjyes ndërsa armiku yt i farësosur. Keutheri që një ofertë nga ana Jonë, ndërsa nami, fama dhe ngadhënjimi ndaj armikut do të ofrohen pasi të shprehësh bindje dhe nënshtrim **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”**. Pra më adhuro Mua, dhe pasi ta bësh këtë gjë kërko ndihmë prej meje, sepse Unë ia kam bërë detyrë vetes që pas çdo namazi farz të ketë një lutje që merr përgjigje. Dhe vetëm atëherë Unë do t'i përgjigjem lutjes tënde dhe armiku yt do të jetë i farësosur. Ky është edhe kuptimi i ??????? – *el-ijta*, dhe është pikërisht kjo çfarë të vjen ndërmend në fakt tek komenton fjalën e Zotit **“Ne të kemi dhënë ty”**. Ndërsa el-Keuther në gjuhën arabe përdoret për çdo gjë me bollëk. Njeriu që është bujar i madh quhet gjithashtu el-keuther. Edhe pluhuri kur është i dendur në natyrë quhet el-keuther, por dijetarët e tefsirit kanë dhënë interpretime pa fund lidhur me këtë term:

Interpretimi i parë: el-Keuther është një lumë në xhenet. Ky është mendimi klasik dhe më i mirënjohur. Enesi -Zoti qoftë i kënaqur me të- transmeton se profeti Muhamed ka thënë: **“Pashë një lumë në xhenet, brigjet e të cilit ishin si kupola me perla të zbrazëta, zhyta dorën në rrjedhën e tij dhe ndjeva një aromë të fortë miski. Çfarë është ky?, -pyeta unë. Keutheri që të ka dhënë Zoti, -u përgjigj dikush.”** Një transmetim tjetër i të njëjtës ngjarje shton: **“Ai ishte më i bardhë se qumështi, më i ëmbël se mjalti, aty gjendeshin shpendë ngjyrë jeshile, qafëgjatë si qafat e deveve. Kush ushqehet me mishin e zogjeve dhe pi ujë në atë lumë arrin lumturinë.”**

Lumi në fjalë është quajtur el-keuther ose sepse është lumi me prurjen më të madhe të ujit dhe edhe më i begati, ose sepse prej tij burojnë lumenjt e Xhenetit, sepse siç edhe kanë thënë; nuk ka kopsht në xhenet e të mos ketë një degë të lumit el-keuther që lundron pranë tij. Ose për shkak të numrit të madh të personave që do të pinë ujë në të, ose për shkak të dobive të shumta që ka, sepse Profeti -paqja e Zotit qoftë për të- ka thënë: **“Ai është lumi që më ka premtuar Zoti im, në të ka dobi pa fund.”**

Interpretimi i dytë: Ai është një hauz i madh, dhe argumentet që e mbështesin këtë pretendim janë të njohura. Ka një pikë pajtimi mes dy mendimeve në fjalë; ndoshta rrjedha e ujit të lumit përfundon në këtë hauz, ose ndoshta lumenjtë e xhenetit burojnë nga ky hauz i madh.

Interpretimi i tretë: el-Keuther janë fëmijët e Muhamedit, sepse kjo sure ka një shkak pse është shpallur, që është një kundërpërgjigje për ata që menduan se Muhamedi është i farësosur, me

pretekstin e vdekjes së fëmijëve të tij. Pra në këtë kuptim, Zoti do t'i japë Muhamedit pasardhës që do të jetojnë sa të jetë bota. Imagjino sa pjestarë të familjes së tij janë vrarë, megjithatë në botë vazhdon të ketë plot anëtarë të familjes së tij, ndryshe nga familja e beni Umejes, për të cilët askush nuk ka interes. Shihni gjithashtu sa dijetarë të mëdhenj kanë dalë nga kjo familje e bekuar; el-Bakir, el-Sadik, el-Kadhim dhe el-Rida -paqja dhe mëshira e Allahut qofshin për ta-.

Interpretimi i katërt: el-Keuther janë dijetarët e këtij umeti që janë një begati e madhe në vetvete, sepse ata janë si profetët e bijve të Izraelit.

Ata gjithmonë e kujtojnë të Dërguarin e Zotit, dhe synojnë të përcjellin gjurmët e fesë dhe veçoritë e sheriatit. Profetët ishin unanim në lidhje me parimet mbi njohjen e Zotit, por kishin diferenca për nga karakteristikat e sheriatit të gjithësecilit, një lehtësim i madh për njerëzimin duhet thënë, porë kjo në dy aspekte:

Aspekti i parë: Transmetohet se në Ditën e Gjykimit do të paraqitet çdo profet e mes tyre do të ketë të dërguar që kanë një ose dy pasues, ndërkohë që do të ketë dijetarë nga umeti i Muhamedit pasuesit e të cilit do të jenë me mijëra dhe të gjithë do të mbledhen pranë profetit Muhamed. Madje numri i pasuesve të një dijetari të vetëm ndoshta tejkalon numrin e pasuesve të një mijë profetëve.

Aspekti i dytë: Profetët e njohin të vërtetën përmes zbulesës, ndërsa dijetarët arrijnë tek ajo përmes sakrificës dhe përpjekjes, dhe madje edhe ata që pas përpjekjes gabojnë do të shpërblehen.

Interpretimi i pestë: el-Keuther është vetë profecia sepse nuk ka asnjë dyshim se profecia është begati e madhe, sepse ajo qëndron në rend të dytë pas Zotit, prandaj Allahu thotë në Kuran: **“Kush i bindet të dërguarit i është bindur Allahut”** (Surja el-Nisa:80). Profecia është gjysma e besimit, madje filiza ku lind njohja e Zotit, sepse njohja e profecisë paraprihet nga njohja e qenies së Zotit, dijes, fuqisë dhe urtësisë së Tij, dhe përmes kontaktit me profecinë bëhet e mundur njohja e pjesës tjetër të attributeve të Zotit, dëgjimi, shikimi etj ose cilësitë në rendin e mëshirës dhe faljes. Profeti ynë gëzon respektin maksimal në piramidën e vlerave, emri i tij kujtohet para të gjithë profetëve edhe pse ai është shpallur pas tyre profet. Ai është profet për të dy llojet; njerëzit dhe xhindët, dhe në Botën Tjetër do të ringjallet para të gjithë profetëve. Sheriati i tij nuk mund të abrogohet më, ndërsa qëndron superior ndaj të gjithë profetëve. Le të përmendim disa arsye këtu:

Libri që Zoti i shpalli Ademit përbëhej nga disa fjalë, siç thotë Allahu në Kuran: **“Ademi mësoi disa fjalë nga Zoti i tij”** (Surja el-Bekare:37), po ashtu libri i Ibrahimit **“Kur Allahu e provoi Ibrahimin me disa fjalë”** (Surja el-Bekare:124), libri i Musait përbëhej nga disa fletushka **“Fletushkat e Ibrahimit dhe Musait”** (Surja el-Ala:19) ndërsa libri që Zoti i shpalli Muhamedit -alejhi salam- është mbikqyrës i të gjithë librave të mëparshëm, Allahu thotë në Kuran: **“dhe mbrojtës i tyre”** (Surja el-Maide:48).

Ademi (a.s.) i sfidoi engjëjt me disa fjalë të parenditura **“Më tregoni emrat e tyre”** (Surja el-Bekare:31), ndërsa Muhamedi (a.s.) i sfidoi kurejshët me fjalët më perfekte **“Thuaj: “Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhindet për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri – tjetrin.”** (Surja el-Isra: 88)

Zoti e nderoi Nuhun duke mundësuar që anija e tij të lundrojë mbi ujë, ndërsa Muhamedit (a.s.) i dha diçka edhe më të madhe se kaq. Tregohet se profeti Muhamed po qëndronte buzë një pellgu me ujë bashkë me Ikrime ibn ebi Xhehlin, ky i fundit i kërkon ta bëjë gurin të lundrojë mbi ujë pa u zhytur në të nëse pretendon se është vërtet profet. Profeti drejtoi gishtin nga guri dhe ai mori të lëvizë dhe lundroi

mbi ujë derisa u vendos në duart e profetit dhe ra në shehadet. Mjafton kjo?! -iu drejtua profeti Ikrimes. Jo, derisa të kthehet sërish në vendin e tij. Profeti i dha urdhër gurit dhe ai u kthye në vendin e tij.

Allahu e ka nderuar edhe Ibrahimin, për të Zoti e bëri zjarrin paqe dhe freski, por Muhamedit i rezervoi një nderim edhe më të madh. Muhamed ibn Hatib thotë: “Kur isha i vogël derdhet mbi mua një enë me ujë që ishte mbi zjarr dhe më digjet lëkura. Nëna më dërgoi tek i dërguari i Allahut dhe i tregoi se unë isha djegur me ujë. I Dërguari i Zotit pështyu në lëkurë dhe fërkoj me dorë pjesën e djegur dhe u lut ‘Largoje këtë sëmundje o Zot i njerëzve!’ pastaj u shërova sikur të mos kish ndodhur asgjë.”

Allahu e nderoi aq shumë Musain sa për të hapi detin në tokë, ndërsa Muhamedin e nderoi edhe më shumë duke ndarë në dy pjesë hënën në qiell.

Për Musain e nxorri ujin prej shkëmbinjve, ndërsa Muhamedit i mundësoi ta nxjerrë atë prej gishtërinjve.

Musain e nderoi Zoti duke bërë që retë t'i bëjnë hije, të njëjtën gjë ia mundësoi edhe Muhamedit.

Musait i dha një shenjë të qartë, dorën që shndriste, ndërsa Muhamedit edhe më shumë se kaq, Kuranin e madhnueshëm, drita e të cilit prek lindjen dhe perëndimin.

Shkopin e Musait Zoti e shndërroi në gjarpër, ndërsa Ebu Xhehli vuri re dy të tillë mbi shpatull tek tentoi ta godasë me gurë profetin -alejhi selam- dhe u largua i frikësuar.

Malet i bënin lavd Zotit bashkë me Daudin, ndërsa gurët e lavdëronin Zotin në duart e Muhamedit dhe shokëve të tij.

Hekri zbutej në duart e Daudit, ndërsa delja shterpë mori të japë qumësht prej durve të Muhamedit.

Daudin Zoti e nderoi me shpendë që tuboheshi përreth tij, ndërsa Muhamedin me Burakun.

Isain e nderoi duke i dhënë mundësinë të shërojë të vdekurit, por edhe Muhamedin e nderoi duke i mundësuar diçka të tillë. Mishi që i ofruan hebrenjtë që i helmuar, dhe me të vënë kafshatën në gojë ajo (që kishte përgatitur mishin e helmuar) e njoftoi. Madje shëroi të lebrosurin dhe të verbërin. Bashkëshortja e Muadh ibn Afrasë ankohet tek profeti sepse ishte e lebrosur. Ai e fërkoj me një degë peme dhe Allahu e shëroi.

Në betejën e Uhudit dikujt i ra syri fallco në dyluftim, profeti ia vendosi sërish në vend.

Isai a.s kishte aftësinë të dinte çfarë fshehnin njerëzit në shtëpitë e tyre, ndërsa profeti e dinte çfarë fshehu xhaxhai tij dhe Umu Fadël, dhe pasi i tregoi, Abasi u bë mysliman.

Për nevojat e Sulejmanit Zoti e frenoi diellin të perëndojë, edhe Muhamedit ia mundësoi një gjë të tillë pasi e kishte zënë gjumi në prehërin e Aliut dhe tek u zgjua vuri re se dielli po perëndonte, Zoti e ktheu diellin sa u fal Muhamedi, madje edhe Aliu e përjetoi një mrekulli të tillë derisa mundi të falë namazin e ikindisë në kohë.

Zoti i mësoi Sulejmanit gjuhën e zogjve, gjë të cilën e zotëronte edhe Muhamedi a.s.

Një herë një zog i ankohet të dërguarit të Zotit për të voglin e saj, kush ia ka marrë të voglin këtij

zogu?,-pyeti ai. Unë, -u përgjigj dikush. Ktheja sërish, -tha ai. Edhe historia e ujkut është mjaft e njohur.

Sulejmanit Zoti ia nënshtroi erën, me të cilën udhëtimin e një muaji ai e bënte brenda një paraditeje ose një pasditeje, ndërsa Muhamedit i dha mundësinë të udhëtojë drejt Kudsit brenda një ore. Ai ia dërgonte gomarin kujt kishte nevojë për të udhëtuar dhe ai e shpinte vetë në destinacionin e duhur.

Një herë iu ankuan për një deve të tërbuar dhe sapo iu afrua ajo u zbut.

Muadhin e dërgoi me mision në një vend dhe gjatë rrugës në një zonë të shkretë përballet me një luan. Nga frika nuk guxonte të lëvizte dhe i tha: “Unë jam mesazheri i të dërguarit të Allahut, ndërsa luani mori të tundë bishtin.”

Xhindët iu nënshtroan Muhamedit ashtu siç qenë nënshtroar para Sulejmanit.

Një nomad iu shpreh Muhamedit se nuk do ta besoj profecinë tënde derisa të besojë hiena ime, në atë moment hiena foli.

Gjarpri që e pickoi Ebu Bekrin në thembër brenda në shpellë tha: kam shumë vite që e pres me mall atë përse më pengove?

Ai ka ushqyer shumë njerëz me pak ushqim dhe në fakt mrekullitë e tij janë pa fund, prandaj Allahu e për zgjedhurve: **“Ne lidhëm besën me ty (o Muhamed) siç bëmë me profetët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes, Ne lidhëm me ata një besë solemne.” (Surja el-Ahzab:7)**, dhe përderisa mesazhi i tij që i tillë, është e arsyeshme që Zoti ta emërtojë el-Keuther **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**.

Interpretimi i gjashtë: el-Keuther është Kurani, dhe cilësitë e tij të larta janë pa fund: **“Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t’i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut.” (Surja el-Ankebut:27)**, dhe **“Thuaj: “Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, sigurisht që ai do të shterej, para se të soseshin fjalët e Zotit tim, edhe sikur Ne të sillnim si ndihmë edhe një det tjetër si ai.” (Surja el-Kehf:109)**

Interpretimi i shtatë: el-Keuther është Islami, dhe ju betohem që është bereqet pa fund. Kush e përvetëson atë fiton të mirat e dy botëve, ndërsa kush e humb atë dështon në të dy botët. Dhe në fakt s’ka se si të jetë ndryshe, sepse Islami simbolizon njohjen, ose çfarë është e domosdoshme të njihet. **“Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kuranit) kujt të dojë. Cilatdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.” (Surja el-Bekare:269)**, dhe në qoftë se Islami është mirësia e madhe atëherë ai është el-keutheri. Po në qoftë se dikush pyet përse e personalifikon el-Keutherin me Islamin ndërkohë që mirësia e tij i përfshin të gjitha?! Sepse përmes tij Islami arriti tek të tjerët, dhe në këtë kuptim profeti konsiderohet origjina e tij.

Interpretimi i tetë: el-Keuther janë pasuesit e shumtë, dhe nuk ka dyshim se ai ka aq shumë pasues sa vetëm Zoti mund ta dijë numrin e tyre. Profeti a.s ka thënë: **“Unë jam produkt i lutjes së të dashmit të Allahut, Ibrahimit, përgëzim i Isait, ndërmjetësues i pranuar Ditën e Gjykimit. Ndërkoqë që qëndroj bashkë me profetët na shfaqet një umet, marrim t’i shoqërojmë me sy, dhe çdonjëri prej nesh shpreson të jetë umeti i tij. Gjymtyrët e tyre shkëlqejnë prej gjurmëve të avdesit. Për një moment them ky është umeti im për Zotin e qabesë! Ata futen në xhenet pa gjyq. Pastaj shfaqet sërish një umet tjetër njësoj si i pari. Marrim t’i shoqërojmë me sy, dhe çdonjëri prej nesh shpreson të jetë umeti i tij. Gjymtyrët e tyre shkëlqejnë prej gjurmëve të avdesit, dhe për një moment them ky është umeti im për Zotin e qabesë! Ata futen në xhenet pa gjyq. Pastaj shfaqet**

një umet tre herë më i madh se dy të parët. Marrim t'i shoqërojmë me sy, dhe çdonjëri prej nesh shpreson të jetë umeti i tij. Gjymtyrët e tyre shkëlqejnë prej gjurmëve të avdesit, dhe për një moment them ky është umeti im për Zotin e qabesë! Pastaj profeti shton: Do të futen tre grupe nga umeti im në xhenet para të gjithë njerëzve.”

Gjithashtu profeti a.s ka thënë: **“Martohuni, trashëgohuni të shtoheni, sepse unë do të mburrem me ju para umeteve të tjera Ditën e Gjykimit, madje edhe më foshnjen e lindur para kohe.”**

Në qoftë se Profeti do të mburret edhe me ata që nuk kanë mbushur moshën e maturisë po me këtë numër kaq të stërmadh njerëzish çfarë mund të thuash?! Pra në këtë kontekst Zoti i kujton Muhamedit këtë bekim të madh **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**

Interpretimi i nëntë: el-Keuther nënkupton virtytet e larta të profetit Muhamed (a.s), sepse pa dyshim ai është profeti më i mirë mes gjithë profetëve. Mufadel ibn Seleme thotë: Quhet el-keuther një person që është shumë bujar dhe i mbarë. Ndërsa në fjalorin *el-Sihah* fjala el-Keuther shpjegohet; Një zotëri bamirës i madh. Pra me qenë se Allahu e ka pajisur Muhamedin (a.s.) me virtyte kaq të larta, është normale që t'ia kujtojë këtë bekim të madh **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**.

Interpretimi i dhjetë: el-Keuther ka kuptimin nam i madh, dhe në fakt këtë gjë e kemi sqaruar kur komentuar ajetin e katërt në surën el-Inshirah: **“dhe ta ngritëm lart emrin?!”**

Interpretimi i njëmbëdhjetë: el-Keuther simbolizon dijen, dhe i komentuar kështu është më i drejtë për disa arsye:

Arsyeja e parë: Ne e dimë që dija ka dobi pa fund, Allahu thotë në Kuran: **“Të mësoi atë që nuk e ke ditur. Dhuntia e Allahut për ty është shumë e madhe.”** (Surja el-Nisa:113). Madje Zoti e nxit Muhamedin të kërkojë dije: **“dhe thuaj: “O Zoti im, shtoma diturinë!”** (Surja TaHa:114) Madje Zoti e quan urtësinë mirësi e madhe: **“Cilitdo që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe.”** (Surja el-Bekare: 269)

Arsyeja e dytë: Ne kemi dy mundësi; ose ta konsiderojmë el-Keutherin si begati të Botës Tjetër, ose si begati të Kësaj Bote. E para është e pamundur, sepse Allahu thotë Ne ta dhamë ty, ndërsa begatitë e Botës Tjetër i takojnë të ardhmes, pra do t'i japim. Për këtë arsye duhet ta konsiderojmë el-Keutherin si begati të kësaj bote, dhe në këtë kuptim begatia më e madhe që mund ta përfaqësojë el-Keutherin është dija sepse edhe profecia përfshihet në të, prandaj pa frikë mund të themi se el-Keuther përfaqëson dijen.

Arsyeja e tretë: Ajetin e parë të sures el-Keuther **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** Allahu e shoqëron me ajetin e dytë **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”**, dhe ne e dimë se dija e paraprin adhurimin, për këtë arsye edhe në suren el-Nahël, ajeti 2, Allahu thotë: **“Paralajmëroni se s'ka zot tjetër të vërtetë përveç Meje, prandaj të më kini frikë Mua!”**, ndërsa në suren TaHa, ajeti 14, Allahu thotë: **“Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro”**, dhe në qoftë se e vëmë re në të dyja suret dija e paraprin adhurimin.

Ekziston edhe një argument tjetër që mbështet këtë tezë: lidhëza nënrenditëse ??-fë – dhe e përdorur në këtë ajet, jep kuptimin e një veprimi që ndodh menjëherë pas një tjetri, që është shprehja më e qartë se dhurimi i el-Keutherit është motivi i këtij adhurimi, dhe ne e dimë tashmë se motivi i adhurimit

është dija.

Interpretimi i dymbëdhjetë: el-Keuther është morali i lartë. Thonë se prej moralit të lartë përfitojnë të gjithë; i dituri, i padituri, kafsha dhe njeriu i arsyeshëm, ndryshe nga dija prej të cilës përfitojnë veç mendarët, prandaj fjala el-Keuther duhet të ketë këtë kuptim. Dhe i tillë ishte i dërguari i Allahut në fakt. Baba për të huajt, u zgjidhte problemet dhe mbulonte hallet, madje morali i tij arriti deri në atë pikë sa kur i thyen dhëmbin gjatë një beteje tha: **“O Zot udhëzoje popullin tim sepse ata nuk dinë!”**

Interpretimi i trembëdhjetë: el-Keuther nënkupton një pozitë të lartë që në rastin konkret bëhet fjalë për privilegjin e madh për të ndërmjetësuar për njerëzimin në Ditën e Gjykimit. Në këtë jetë **“Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre”** (Surja el-Enfal:33), ndërsa në Botën Tjetër **“Ndërmjetësimi im do të përfshijë mëkatarët e umetit tim.”** Ndërsa nga Ebu Hurejre transmetohet se profeti a.s ka thënë: **“Çdo profet kishte të rezervuar një lutje të pranuar, ndërsa unë e kam rezervuar atë për umetin tim në Ditën e Gjykimit.”**

Interpretimi i katërbëdhjetë: el-Keuther është vetë surja në fjalë që megjithëse është e shkurtër mjafton për të përfaqësuar të gjitha të mirat e dy botëve, sepse ajo përfshin mrekullinë gjë që mund të konfirmohet në këto aspekte:

Aspekti i parë: Nëse do ta interpretojmë el-Keutherin si numri i madh i pasuesve, ose numri i shumë të fëmijëve dhe mosndërprerja e trashëgimisë, ky do të ishte një informacion mbi të fshehtën, gjë që ka ndodhur pikërisht kështu në fakt, dhe kjo gjë sigurisht që është një mrekulli.

Aspekti i dytë: Allahu thotë: **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”** ky ajet tregon se varfëria do të zhduket përndryshe si do ta kishte të mundur Muahmedi të bënte kurban, dhe në fakt kështu ndodhi, edhe kjo është një mrekulli.

Aspekti i tretë: **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur.”** dhe në të vërtetë ata që e urrenin profetin u zhdukën, e si mos të jetë e gjitha kjo një mrekulli?!

Aspekti i katërt: Ata nuk ishin në gjendje të ballafaqoheshin me këtë sure edhe pse është shumë e shkurtër, gjë që konfirmon se mrekullia e Kuranit gjendet në përsosmërinë e tij, sepse përderisa ata nuk ishin në gjendje të ballafaqoheshin me një sure të shkurtër me siguri që të ballafaqohen me tërë Kuranin e kanë edhe më të pamundur. Pra kjo sure është një mrekulli në vetvete gjë që konfirmon profecinë. Dhe në qoftë se konfirmohet profecia atëherë duhet të pranojmë edhe teuhidin, njohjen e Krijuesit, Fenë Islame, dhe se Kurani është Fjalë e Zotit. Nëse konfirmohen të gjitha këto, atëherë konfirmohen të gjitha të mirat e dy botëve.

Kjo sure shfaqet si një pikë e fortë dhe e aftë të përfshijë të gjitha qëllimet brenda vetes. Vërtet është e shkurtër për nga forma por shumë e gjërë për nga përmbajtja. Por ka edhe një karakteristikë tjetër që s’e ka asnjë sure, sepse ajo ka veç tre ajete. Ne e kemi bërë të qartë tashmë se secili prej tyre është një mrekulli, pra çdo ajet më vete është një mrekulli, dhe të gjitha ajetet bashkë janë një mrekulli më vete. Kjo veçori nuk gjendet në të gjitha suret, kështu që ka shumë mundësi që el-Keuther të jetë vetë kjo sure.

Interpretimi i pesëmbëdhjetë: el-Keuther janë të gjitha begatitë që Zoti i ka dhënë Muhamedit (a.s.) Ky pohim transmetohet nga Ibn Abasi, sepse termi el-Keuther i referohet sasisë së stërmadhe, dhe ta interpretosh këtë ajet duke përfshirë disa begati dhe anashkaluar disa të tjera nuk është e

përshtatshme, për këtë arsye ai duhet t'i përfshijë të gjitha ato.

Seid bin Xhubejr kur e transmetoi këtë mendim të Ibn Abasit, disa persona i thanë: Disa njerëz pretendojnë se ai është një lum në Xhenet. Seidi iu përgjigj: "Lumi që gjendet në Xhenet është një nga mirësitë e mëdha që i ka dhënë Zoti."

Disa dijetarë pretendojnë se kuptimi i dukshëm i këtij ajeti: **"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira"** është pohimi se Allahu ia ka dhënë tashmë Muhamedit (a.s.) el-Keutherin, në këtë kuptim ky ajet duhet të interpretohet në frymën e begative të cilat Zoti ia ka dhënë tashmë Muhamedit të cilat përfshijnë; profecinë, Kuranin dhe përkrahjen kundra armiqve. Sa i përket luginës dhe shpërblimeve të tjera që ka rezervuar për të, edhe nëse mund të na lejohet të shprehemi se ato përfshihen të gjitha sepse mjafton të konfirmohet si premtim i Zotit dhe është njësoj si të ketë ndodhur në realitetit, por e vërteta është ajo që kemi pohuar më parë, sepse këto begati edhe pse janë rezervuar për të, nuk është me vend të themi se Zoti ia dha Muhamedit këto të mira në momentin që zbriti kjo sure në Mekë.

Dhe në mbështetje të kësaj teze mund të themi gjithashtu se kushdo që i dhuron fëmisë së tij një pasuri të caktuar, pasuria në fjalë konsiderohet e tij edhe pse fëmija është i paaftë ta menaxhojë atë. Allahu e di të vërtetën.

"andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!" (Surja el-Keuther:2)

Në këtë ajet përfshihen disa çështje:

Çështja e parë: Folja ?? – *salī* – falu e shprehur në mënyrën urdhërore ka disa kuptime:

1. Është urdhër për namaz. Por nëse dikush nuk pajtohet duke argumentuar se në raste të tilla më e përshtatshme është të falenderosh se të falesh, do t'i përgjigjem në disa mënyra:

E para: Falenderimi është shprehje e nderimit dhe ka tre kushte;

Kushti i parë lidhet me zemrën, që do të thotë se personi në fjalë duhet ta dijë që këtë të mirë e ka veç prej Zotit dhe prej askujt tjetër.

Kushti i dytë lidhet me gjuhën, pra ta lavdërojë Atë.

Kushti i tretë lidhet me veprën, pra t'i shërbejë dhe të tregohet modest para tij, dhe në fakt namazi i përmban të gjitha këto, madje përmban edhe më shumë se kaq, kështu që urdhëri për t'u falur përfshin krahas shumë të tjerave edhe falenderimin, prandaj ky urdhër vlen më shumë.

E dyta: Në qoftë se do ta urdhëronte të falenderojë kjo do të jepte përshtypjen se ai nuk ka qenë falenderues, ndërkohë që e kundërta është e vërtetë, i dërguari i Zotit gjithmonë e ka njohur Zotin, i është përlurur, bindur dhe e ka falenderuar për të mirat që i ka dhënë, ndërsa namazin e mësoi përmes shpalljes **"Ti më parë nuk e ke ditur se çfarë është Libri e as ç'është besimi."** (Surja el-Shura:52)

E treta: Në momentin e parë që Zoti e urdhëron të falet, Muhamedi shfaq si dilemë faktin sesi të falem kur nuk kam avdes?! Ndërsa Allahu iu përgjigj **"Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty el-Keutherin"**, pastaj Xhibrili goditi tokën me krahun e tij dhe prej saj buroi uji i el-Keutherit dhe profeti mori avdes, në këtë moment mori edhe urdhërin për namaz. Dhe po qe se ne e interpretojmë el-Keutherin si shpallje

atëherë kuptimi do të ishte se Ne të kemi dhënë profecinë që të nxitësh veten dhe shoqërinë të adhurojnë Zotin, dhe duke qenë se namazi është kryeadhurimi i adhurimeve atëherë falu për Zotin tënd.

2. Andaj falu për Zotin tënd domethënë falenderoje Zotin tënd. Këtë mendim përkrah Muxhahidi dhe Ikrime. Duke e komentuar kështu këtë ajet kuranor, nga lidhëza nënrenditëse *fe* tek folja *fe sali* – andaj falu nxjerrim disa kuptime:

Kuptimi i parë: Shërben për të tërhequr vëmendjen dhe për të kujtuar se falenderimi për mirësitë duhet të bëhet menjëherë pra nuk duhet të ketë vakum kohor.

Kuptimi i dytë: Lidhëza nënrenditëse *fe*-dhe konfirmon kuptimin e ajetit kuranor **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”**, më specifikisht ajo e intensifikon urdhërin drejtuar Muhamedit me këto fjalë **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”**, sepse Zoti i thotë në Kuran **“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort në adhurim”**. Pra pasoje veprën e mirë me një tjetër vepër të mirë. Dhe në qoftë se kjo është sjellja strukturore e Muhamedit, Zoti meriton ta falenderosh menjëherë sapo të jep një të mirë.

3. Falu do të thotë lutju Zotit sepse namazi vjen me kuptimin e lutjes, dhe në qoftë se do ta interpretonim kështu këtë ajet atëherë lidhëza nënrenditëse *fe* në këtë rast do të kishte këtë kuptim. Ne nuk u treguam dorështranguar me ty para se të lutesh, si do të tregohemi të tillë pasi Na lutesh, por **“Kërko të të japim, dhe ndërmjetëso ta pranojmë ndërmjetësimin!”**. E gjithë kjo ndodh sepse ai gjatë gjithë kohës që i brengosur për ymetin e tij. Por duhet të kemi parasysh se interpretimi i parë është më i drejtë sepse shkon më përshtat me kuptimin e sheriatit.

“Për Zotin tënd ther kurban” ka dy qëndrime:

Qëndrimi i parë: Domethënë kurban i zakonshëm dhe ky është edhe qëndrimi i shumicës së komentuesve të Kuranit.

Qëndrimi i dytë: Folja *inher* – ther shpreh një veprim që lidhet me namazin, veprim i cili kryhet, para, gjatë ose pas tij. Dijetarët japin disa interpretime për këtë rast:

1. el-Ferra thotë: Folja *inher* domethënë drejtohu nga kibra.
2. el-Esbeğ ibn Nubate transmeton prej Aliut se kur zbriti kjo sure profeti (a.s) e pyeti Xhibrilin. Çfarë është kjo sakrificë që Zoti kërkon nga unë? Ajo nuk është sakrificë, -u përgjigj ai, por Ai të urdhëron që kur të falesh të ngresh duart gjatë *tekbirit*, kur të bësh ruku, kur të ngresh kokën nga rukuja dhe kur të bësh sexhde, ky është namazi ynë, dhe namazi i engjëjve që janë mbi shtatë qiej. Çdo gjë ka bukurinë e vet, ndërsa bukuria e namazit është ngritja e duarve për çdo tekbir.
3. Transmetohet se Ali ibn Ebi Talib e ka interpretuar fjalën *el-Nehër* me vendosjen e duarve në kraharor gjatë namazit, ai thotë: “Ngritja e duarve para namazit është sjellje e njeriut që kërkon ndihmë dhe mbrojtje, ndërsa vendosja e tyre në kraharor është sjellje e njeriut të përulur dhe nënshtruar.
4. Atà mendon se kuptimi i fjalës *el-Nehër* është të qëndrosh ulur mes dy sexhdeve derisa të

shfaqet dukshëm kraharori.

5. Ndërsa Dahaku dhe Sulejman el-Tejmi mendojnë se folja *inhar* do të thotë ngriji duart deri në kraharor gjatë lutjes. El-Vahidi thotë se të gjitha këto interpretime kanë lindur si rrjedhojë e shumëkuptimësisë së fjalës *el-Nahër* që do të thotë kraharor. Therja e devesë përshembull quhet *el-Nahër*, sepse qafa e saj përfundon në kraharor dhe shfaqet dukshëm, kështuqë fjala *el-Nahër* në këtë rast merr këtë kuptim. Ndërsa el-Ferra mendon se fjala *el-Nahër* do të thotë drejtohu nga kibleja. Edhe Ibn el-Arabi mendon se *el-Nahër* do të thotë të qëndrosh në këmbë gjatë namazit në drejtim të mihrabit, pra kraharori yt të jetë karshi kiblesë, që do të thotë të mos kthehesh as majtas as djathtas gjatë namazit.

Pra në thelb gjithë sa thamë më lart jep përshtypjen se Zoti na thotë se Qabeja është shtëpia ime, dhe është kibleja e namazit dhe zemrës tënde, dhe është kibleja e mëshirës dhe providencës sime, dhe që të dy kibletë le të jenë përballë njëra-tjetrës. Por interpretimi i fjalës *el-Nahër* në kuptimin e kurbanit është më i pranueshëm për disa arsye:

1. Çdo herë që Zoti përmend namazin në Kuran e shoqëron atë me zeqatin.
2. Njerëzit në kohën e Profetit a.s faleshin dhe bënin kurban për idhujt, prandaj Zoti e fton të falet dhe të bëjë kurban për Të.
3. Këto veprime përbëjnë namazin dhe etikën e tij, kështu që automatikisht janë përfshirë në fjalën e Zotit **“Falu për Zotin tënd”**, për këtë arsye duhet të aludojmë se fjala *el-Nahër* nënkupton diçka tjetër, sepse është e palogjikshme që pjesa të lidhet me të tërën.
4. Folja *fe sali* – dhe falu, është tregues i përndërimit të urdhërit të Zotit, ndërsa folja *ve inhar* – dhe bëj kurban, është tregues i dhembshurisë për krijesat e Zotit, dhe në thelb adhureshmëria nuk shkon përtej këtyre dy kritereve.
5. Përdorimi i fjalës *el-Nahër* me kuptimin e kurbanit është më i njohur se përdorimet e tjera, për këtë arsye ky ajet duhet interpretuar kështu, dhe në qoftë se e pranojmë këtë atëherë duhet të themi se Hanefitë janë mbështetur pikërisht në këtë fakt për të dalë në konkluzionin se kurbanit është obligim, sepse Zoti e urdhëron të dërguarin e tij të bëjë kurban, dhe me siguri ai ka bërë kurban, sepse është e papranueshme që i dërguari i Tij të lejë pa zbatuar një urdhër të caktuar, dhe në qoftë se një gjë të tillë e ka zbatuar i dërguari i Zotit atëherë obligohemi edhe ne ta zbatojmë sepse Allahu thotë në Kuran: **“dhe pasojeni atë!”** (Surja el-Araf:158), **“më pasoni mua që t’ju dojë Zotit” (Ali Imran:31)**, por dijetarët e shkollës sonë pretendojnë se detyrimi për të ndjekur shembullin e tij specifikohet me një tjetër urdhër: **“Tre gjëra janë detyrë veç për mua dhe për askënd prej jush: namazi duhasë, kurbanit dhe namazi vitrit.”**

Çështja e tretë: Edhe ata që foljen *fe sali* e kanë interpretuar falu kanë mosmarrëveshje për natyrën e faljes.

Mendimi i parë: Fjala namaz nënkupton vetë namazin në kuptimin klasik, sepse kurejshët faleshin për idhujt dhe bënin kurban për ta, ndërsa Allahu e urdhëroi Muhamedin të falet dhe bëjë kurban veç për Të. Shkolla që pranon vonimin e sqarimit të një norme të përgjithshme argumentohet pikërisht me këtë ajet, sepse Zoti e urdhëron të dërguarin e tij të falë namaz edhe pse nuk sqaron mënyrën e faljes. Ndërsa Ebu Muslim në përgjigje të këtij pretendimi thotë: “Këtu bëhet fjalë për pesë namazet e detyrueshme, dhe vërtet këtu nuk sqarohet natyra e namazit sepse një gjë e tillë që e njohur tashmë.”

Mendimi i dytë: Fjala namaz nënkupton namazet e dy Bajrameve, sepse kurejshët bënin Kurban pastaj faleshin për këtë arsye u shpall ky ajet. Por dijetarët e mëvonshëm konsiderojnë se ky interpretim

është i dobët sepse lidhëza nënrenditëse ve (d.m.th., ne) nuk nënkupton domosdoshmërisht renditjen mes veprimeve.

Mendimi i tretë: Seid ibn Xhubejr pretendon se folja *fe sali* (falu) domethënë fal namazin e mëngjesit në Muzdelife dhe bëj kurban në Mina.

Mendoj se interpretimi i parë është më i drejtë sepse shoqërimi i namazit me kurbanin në këtë ajet nuk do të thotë domosdoshmërisht se ky namaz është ai që kryhet ditën e Kurban Bajramit.

Çështja e katërt: Në ajetin e dytë fjala *Rabike* shoqërohet me një?? – li që në gjuhën shqipe përktthehet **për** e cila përfshin disa dobi:

Dobia e parë: Parafjala në fjalë në raport me namazin merr funksionin e shpirtit për trupin, sepse trupi nga koka tek këmbët është i këndshëm dhe vital prej shpirtit, përndryshe është i vdekur dhe të ngjall neveri, njëjtë edhe namazi të cilin edhe nëse e kryen bukur në dukje, në qoftë se i mungon *li*-ja pra për Zotin, shndërrohet në një coftinë të braktisur. Edhe Musain kështu e urdhëron Zoti **“dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!”** (Surja TaHa:14). Pra me qenë se ata faleshin dhe bënë kurban për idhujt Zoti i jep urdhër Muhamedit të falet dhe bëjë kurban për Të.

Dobia e dytë: Pra si të thuash, që me qenë se ata falen për syfaqe siç theksohet në suren e mëparshme, ti falu për Zotin tënd jo për syfaqe por me sinqeritet.

Çështja e pestë: Lidhëza ?? – *fe* (d.m.th. dhe) e përdorur në këtë ajet është përdorur si shkakësi e dy çështjeve:

E para: Shkakësi e adhurimit, pra si të thuash shtimi i begative të Zotit të obligon të përkushtohesh në adhurim.

E dyta: Shkakësi e indiferencës, ndërkohë që ata pretendonin se ti je farësosur, ne të begatuam me kaq shumë të mira, pra përkushtohu në adhurim dhe mos i kushto vëmendje fjalëve të tyre të përçarta.

Dhe duke qenë se për nga natyra njeriu i do gjërat e mira dhe prej dashurisë lind veç dashuri, lidhëza *fe* do të thotë se namazi është një nga pasojat e këtyre mirësive, edhe pse në fakt namazi që shndërruar nga gjërat më të dashura për profetin (a.s.), një herë ai tha: **“Kënaqësia e shpirtit tim gjendet në namaz.”** Ndërsa një herë u fal aq gjatë sa iu enjtën këmbët, dhe kur dikush e pyeti përse falesh kaq gjatë ndërkohë që të janë falur mëkatet e shkuara dhe edhe ato që mund të vijnë, ai u përgjigj: **“Të mos jemë vallë rob falenderues?!”** Ky pohim nga ana e tij nënkupton se unë duhet të përkushtohem në adhurim si pasojë e *fe*-së në fjalën e Allahut **“dhe falu”** (*fe sali*).

Çështja e gjashtë: Më e përshtatshme do të ishte të thuhej, Ne të kemi dhënë ty shumë të mira, prandaj falu për ne dhe bëj kurban, por Allahu në fakt thotë **“dhe falu për Zotin tënd”**, dhe me siguri këtu ka disa dobi:

E para: Ndryshimi i regjistrimit të ligjërimit në këtë ajet është në fakt shenjë e elokuencës së lartë.

E dyta: Zëvendësimi i ligjërimit nga veta e parë në të tretën nënkupton një lloj madhështie dhe pushteti. Edhe pushtetarët kur i drejtohen masave thonë: Kryetari i shtetit ju urdhëron kështu e ashtu, kryetari i shtetit ju ndalon kështu e ashtu.

E treta: Në ajetin kuranor **“Ne të kemi dhënë”** nuk shprehet qartë nëse folësi është veç Allahu apo edhe dikush tjetër, dhe përmeri “Ne” përdoret edhe në numrin shumës por edhe në numrin njëjës kur bëhet fjalë për të shprehur pushtet dhe madhështi, kështu që nëse Allahu do të thoshte falu për ne, kjo mundësi do të zhdukej, kështu që profeti nuk do të kishte si ta dinte se namazi për të cilin po ftohet ta kryejë është veç për Zotin apo hem për Zotin hem për të tjerë krahas Tij, dhe për ta shuar këtë ambiguitet kuptimesh Allahu thotë: **“dhe falu për Zotin tënd”**, gjë që jep veç një kuptim dhe shpreh qartë deklamimin e monoteizmit dhe përkushtimin veç ndaj Zotit.

Çështja e shtatë: **“Dhe falu për Zotin tënd”** ky stil ligjërimesh është më i plotë se **“Dhe falu për Allahun”**, sepse termi Zot (*Rab*) shkon përshtat me vetë përkujdesjen e treguar më herët në ajetin **“Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”** dhe vë në dijeni premtimin e jashtëzakonshëm në të ardhmen se ai do të përkujdeset për ty dhe nuk do të braktisë.

Çështja e tetë: Në këtë ajet ka dy pikëpyetje:

E para: Në Kuran përmendet gjithmonë zeqati pas namazit, përse në këtë ajet pas tij është përmendur kurban?

E dyta: Përse Allahu nuk thotë bëj kurban në mënyrë që të përfshihen të gjithë llojet e bagëtive?

Për pikëpyetjen e parë përgjigjja do të ishte kjo: Në qoftë se do të merrnim në konsideratë se këtu bëhet fjalë për Namazin e Bajramit atëherë çështja është dukshëm e qartë, por nëse do të merrnim në konsideratë se këtu bëhet fjalë për namazin në përgjithësi, atëherë përgjigjja do të ishte e tillë:

1. Mushrikët faleshin dhe bënë kurban për idhujt, kështu që Allahu e urdhëron Muhamedin të falet dhe të bëjë kurban për Të.
2. Profeti (a.s.) zotëronte pak të ardhura aq sa mund të mbante frymën gjallë, dhe kuptohet që në këtë pikë ai s'mund të detyrohet të japë zeqat, ndryshe qëndron çështja kur bëhet fjalë për kurbanin, ai që obliguar për një gjë të tillë, siç pat thënë një herë: “Tre gjëra janë obligim vetëm për mua, nuk janë obligim për umetin tim; Namazi duhasë, kurban dhe namazi vitrit.”
3. Ne e dimë se pasuria më e çmueshme mes arabëve që deveja, dhe Allahu e obligoi profetin të bëjë kurban si shenjë e nënshtrimit ndaj Tij, dhe për të dëshmuar gjithashtu ndarjen me lakmitë e shpirtit dhe kënaqësitë tokësore. Transmetohet se profeti (a.s.) bëri kurban njëqind deve sa u këput nga lodhja, mes tyre edhe deveja e Ebu Xhehlit e cila kishte në hundë një unazë floriri, dhe urdhëroi Aliun të therë ato që mbetën. Devetë shtyhenin me njëra-tjetrën ndërkohë që profeti i bënte kurban, dhe morën të largohen sapo Aliu filloi t'i therë.

Ndërsa për pikëpyetjen e dytë përgjigjja do të ishte kjo:

Namazi është adhurimi më i rëndësishëm fizik për këtë arsye e shoqëron me sakrificën më të madhe, dhe aty ka edhe një indicie tjetër të rëndësishme; ti do të pasurohesh aq shumë sa do të bësh kurban njëqind deve.

Çështja e nëntë: Ajeti në fjalë është argument se namazi do falur para Kurbanit, jo veç për faktin se lidhëza ve (d.m.th. dhe) e përdorur në këtë ajet nënkupton renditje mes veprimeve, por sepse profeti (a.s.) ka thënë: **“Nisjani me atë që Zoti e nis.”**

Çështja e dhjetë: Kjo sure është mekase, ky është qëndrimi më i saktë, në këtë kuptim urdhëri për të bërë Kurban vjen si një sihariq i madh për themelimin e shtetit në të ardhmen, zhdukjen e varfërisë dhe pasigurisë.

“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur.” (Surja el-Keuther:3)

Në këtë ajet përfshihen disa çështje:

E para: Ekzistojnë disa mendime rreth shkakut të shpalljes së kësaj sureje:

Mendimi i parë: Tregohet se profeti (a.s.) po dilte një herë nga haremi i Qabesë në të njëjtën kohë që el-As ibn Vail el-Sehmi po futej në të, dhe shkëmbyen aty disa fjalë, ndërkohë pari kurejshite ishte brenda haremin e qabesë. Pasi el-As futet në të ata e pyetën me kë po bisedoje? Me atë farësosurin, - ia ktheu ai.

Në fakt kjo që një bisedë e fshehtë mes tyre, e megjithatë Allahu e bëri publike gjë që kuptohet që është një mrekulli.

Tregohet gjithashtu se el-As ibn Vail thoshte se Muhamedi është farësosur, sepse ai s'ka një djalë ta trashëgojë, kur të vdesë do t'i shuhet emri dhe do rehatohej prej tij. Kjo ngjarje ka ndodhur në kohën që profetit i vdes djali i tij Abdullahi, të cilin e kishte me bashkëshorten e parë Hatixhenë. Këtë mendim propozon Abdullah ibn Abasi, Mukatil, el-Kelbi dhe shumica e komentuesve të Kuranit.

Mendimi i dytë: Abdullah Ibn Abas thotë: “Kab ibn Eshref erdhi në Mekë, dhe një grup nga paria kurejshite shkon të takohet me të dhe i thonë: Ne jemi mikpritësit e haxhinjve dhe shërbëtorët e shtëpisë së shenjtë, ndërsa ti je fisniku i Medinesë. Kush është më i mirë, ne apo ai farësosuri që pretendon se është më i mirë se ne. Për këtë rast u shpall ajeti kuranor **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”** gjithashtu edhe ajeti **“A nuk i ke parë ata që u është dhënë një pjesë e Librit? Besojnë në idhuj dhe hyjni të rreme dhe thonë për jobesimtarët: “Këta janë në rrugë më të drejtë se ata që besojnë.”** (Surja el-Nisa:51)

Mendimi i tretë: Pasi Zoti i shpalli Muhamedit profecinë dhe ai mori t'u flasë kurejshëve, ata thanë Muhamedi është farësosur, doli nga rruga jonë dhe u nda prej nesh, -thoshte Ikrime dhe Shehër ibn Hevsheb, por Zoti shpalli se në fakt farësosur janë vetë ata.

Mendimi i katërt: Ky ajet është shpallur për Ebu Xhehlin, i cili shfaqti urrejtje ndaj Muhamedit pasi i vdiq djali. Ai thoshte e urrej këtë njeri sepse është farësosur. Sigurisht që kjo sjellje është e palogjikshme sepse njeriu nuk mund të urrehet për diçka që nuk e bën me dëshirën e vet, profeti nuk e kishte në dorë të vdiste apo jo djali i tij.

Mendimi i pestë: Ky ajet është shpallur për xhaxhain e tij Ebu Lehebin, i cili pasi i tha në publik mallkuar qofsh, në mungesë të tij thoshte ai është farësosur.

Mendimi i gjashtë: Ky ajet është shpallur për Ukbe ibn ebi Muajt, sepse ai e thoshte gjithmonë një gjë të tillë.

Por nuk është e çuditshme që idhujtarët mekas ta thonin një gjë të tillë për Muhamedin sepse në fakt kanë thënë edhe më shumë se kaq. Megjithatë mendoj se el-As ibn Vail ishte personi që e përmendte më shumë këtë gjë, dhe për këtë arsye transmetimet se ky ajet është shpallur për të janë më të njohura.

Çështja e dytë: Fjala *sheneanë* e përdorur në këtë ajet do të thotë urrejtje, ndërsa *el-shani* quhet personi që urren. *El-betr*-u do të thotë çrrënjosje. Arabët e quajnë *ebter* një kafshë që e ka bishtin cung, gjithashtu edhe personi që nuk ka trashëgimtar quhet *ebter*, edhe personi që nuk ka të ardhme quhet po ashtu. Dhe me qenë se pabesimtarët pretendonin se profeti është farësosur Allahu mori të sqarojë në këtë sure të vërtetën, duke na treguar se farësosur në fakt janë ata që e urrejnë atë.

Pretendimi i pabesimtarëve se profeti është farësosur do të thotë se ai nuk ka të ardhme. Ky pretendim mund të lidhet me një të mirë specifike por mund të jetë edhe gjithëpërfshirës. Në kuptimin e parë mund të themi:

1. Kur dikujt i ndërronin jetë djemtë, thotë el-Sudi, kurejshët e quanin *ebter*, dhe pasi Kasimi dhe Abdullahi ndërruan jetë në Meke ndërsa Ibrahim i Medine kurejshët thanë Muhamedi është farësosur sepse nuk ka më trashëgimtarë, por Allahu pohon në këtë sure krejt të kundërtën, sepse pikërisht lidhja e tyre e gjakut u zhduk, ndërsa trashëgimtarët e Muhamedit vetëm se shtohen çdo ditë e më shumë.
2. Ata kishin për qëllim me fjalën *ebter* faktin se ai dështoi para se të arrinte qëllimin, por Allahu thotë se në fakt ai që dështoi është kundërshtari i tij, sepse ata ia mbathën nga koka këmbët, u mposhtën dhe nënshtruan, ndërsa flamuri i Islamit u ngrit lart dhe njerëzimi nga Lindja në Perëndim u përul para tij.
3. Ata pretenduan se ai është farësosur sepse nuk e përkrahte dhe mbështeste njeri, kjo është e pavërtetë sepse veç përkrahja e Allahut, Xhibrilit dhe besimtarëve të ndershëm është e mjaftueshme, dhe e vërteta është se vetë pabesimtarët mbetën pa përkrahje dhe ndihmë.
4. *Ebter* është një person i përbuzur dhe poshtëruar. Tregohet se Ebu Xhehli e ftoi parinë mekase në shtëpi dhe gjatë darkës e etiketon profetin me këtë epitet, pastaj tha ngrihuni të shkojmë tek Muhamedi, unë do të dyluftoj me të dhe do ta poshtëroj. Kur arritën tek shtëpia e Hatixhes ajo shtron një qilim pasi ranë dakord për dyluftim. Ebu Xhehli u përpoq disa herë ta rrëzojë profetin (a.s.) por më kot, ai qëndronte në këmbë si një mal. Pastaj profeti e hodhi përtokë Ebu Xhehlin dhe, pasi u ngrit e kapi me të majtën meqë dora e majtë përdoret për t'u pastruar sepse ai i tillë ishte, i pistë, dhe e hodhi edhe një herë përtokë dhe i vuri këmbën mbi kraharor. Disa historianë tregojnë se shkaku i shpalljes së ajetit **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”** është pikërisht kjo ngjarje.
5. Pasi pabesimtarët e quajtën *ebter* profetin (a.s.) Allahu shpalli këtë ajet **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”** që do të thotë se çfarëdo që thonë për ty është e pavërtetë dhe në fakt fjalët e tyre do të harrohen, ndërsa lavdia dhe emri yt do të kujtohet sa të ketë jetë.
6. Një person i thotë Hasenit të birit të Aliut, na nxive fytyrën si ia dorëzove pushtetin Muavijes! Zoti të mëshiroftë, mos më lëndo kaq rëndë!, ia ktheu ai. -Profeti (a.s.) pa në ëndërr sesi fisi Beni Umeje ngjiten në fron njëri pas tjetrit gjë që e mërzi, ndërsa Allahu shpalli ajetin **“Ne të kemi dhënë ty të mira të shumta”, “Ne e kemi zbritur atë në natën e kaderit”**. Pushteti i Beni Umejes zgjati ca por ata u zhdukën pastaj dhe nuk mbeti më njeri gjallë.

Çështja e tretë: Allahu u kundërpërgjigj vetë menjëherë pa ndërmjetësim kur pabesimtarët e ofenduan

profetin (a.s.) **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”**, dhe e tillë në fakt është sjellja mes miqve, ai që të do kur dëgjon se dikush të fyen merr vetë përsipër të përgjigjet, në këtë rast Zoti mori përsipër vetë të përgjigjet për Muhamedin (a.s.) Ka edhe raste të tjera të ngjashme në Kuran: **“Ndërsa jobesimtarët thonë: “A doni t’ju tregojmë një njeri që pretendon se, kur të shpërbëheni plotësisht e të bëheni pluhur, ju, me siguri do të rikrijoheni nga e para? A po trillon gënjeshtër për Allahun apo është i çmendur?” dhe mënjëherë vjen përgjigjja nga vetë Zoti: “(Nuk është kështu), por ata që nuk besojnë në jetën tjetër, do të dënohen dhe janë në humbje të madhe.”** (Surja Sebe:7-8)

Edhe kur e akuzuan për të çmendur, Zoti u betua tri herë para se të përgjigjej: **“se ti (o Muhamed), falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë.”** (Surja el-Kalem:2)

Edhe kur thanë **“Ti nuk je një i dërguar”** (Surja el-Rad:43), Allahu u përgjigj **“Jâ Sîn. Për Kuranin plot urtësi! Në të vërtetë, ti (Muhamed) je një nga të dërguarit.”** (Surja Jasin: 1-3)

Edhe kur thanë **“Vallë, a t’i braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë?”** Allahu ju përgjigj **“Nuk është ashtu (siç thonë ata), por ai (Muhamedi a.s.) ka sjellë të vërtetën dhe ka pohuar atë që thonin të dërguarit e mëparshëm.”**, dhe pasi konfirmon sinqeritetin e të dërguarit i kërcënon kundërshtarët e tij, **“Sigurisht, ju do ta provoni dënimin e dhembshëm.”** (Surja el-Safat:36-38).

Edhe kur tregon se ata thoshin për të se **“Vërtet Ai është poet.”** (Surja el-Tur:30), Allahu përgjigjet **“Ne nuk ia kemi mësuar atij poezinë”** (Surja Jasin:69)

Edhe kur thanë **“Ky (Kuran) është vetëm gënjeshtër, të cilën e ka trilluar ai me ndihmën e njerëzve të tjerë.”** Allahu menjëherë i quan gënjeshtarë ata: **“Kjo që thonë ata është e padrejtë dhe shpifje.”** (Surja el-Furkan:4)

Edhe kur thanë **“Ç’është ky i dërguar që ha ushqim dhe shëtit nëpër tregje?!”** Allahu përgjigjet **“Ne edhe para teje kemi nisur vetëm të dërguar, të cilët hanin ushqim dhe shëtisnin nëpër tregje.”** (Surja el-Furkan:20)

Çështja e katërt: Allahu e dinte se megjithëse të mirat që i dha profetit të Tij qenë pa fund kënaqësia nuk do të ishte e plotë në qoftë se kundërshtarët e tij nuk do të mposhteshin, dhe Zoti ia premtoi këtë gjë përmes ajetit **“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është farësosur”**. Këtu mund të nxjerrim disa dobi:

Dobia e parë: Sikur Zoti ka dashur t’i thotë, le të mbijetojë edhe ca sa të shikojë themelimin e shtetit tënd, dhe të përjetojë dështimin e vet dhe të vdesë nga mllef.

Dobia e dytë: Zoti e cilëson armikun e Muhamedit si xheloz, si një njeri që ka urrejtje, për të treguar se ai që të urren nuk mund të bëjë më shumë se kaq, dhe kur njeriu arrin në këtë pikë i digjet zemra dhe mbytet në mllef dhe xheloz. Armiqësia është shkak kryesor i fatkeqësisë së tij.

Dobia e tretë: Ky ajet tregon se ai përfundoi farësosur sepse e urrente, kjo është e vërtetë në fakt, kush ka zili profetin që është subjekt i zilisë, në fakt i ka shpall luftë Zotit, aq më tepër kur bëhet fjalë për një person famën e të cilit e ka marrë përsipër vetë Zotit.

Dobia e katërt: Kundërshtarët e konsideronin Muhamedin të përbuzur dhe papërkrahur, ndërsa veten të fuqishëm dhe të shumtë, por Allahu i përmbysi këto premisa, krenar është ai që e nderon Zoti, ndërsa i përbuzur ai që e përbuz Zoti. Të mirat e shumta dhe përkrahja i përkasin Muhamedit, ndërsa poshtërimi dhe fatkeqësia kundërshtarëve të tij. Kështu që mes fillimit dhe fundit të sures ka një harmoni të jashtëzakonshme.

Çështja e pestë: Cilido që mediton fillimin e kësaj sure dhe pjesët e saj do ta vërë re se çfarëdo urtësie që jemi munduar ta cekim këtu derimë tani është shumë pak krahasuar me urtësitë dhe sekretet që i di veç Zoti, çfarë ne kemi thënë mund të krahasohet me një pikë uji në det.

Tregohet se Musejleme, një person që pretendonte profecinë, mori ta sfidojë Kuranin dhe shpiku një sure të ngjashme me suren el-Keuther, por fatkeqji harroi se nuk mund ta arrinte këtë lartësi për disa arsye:

E para: Si shprehjet e përdorura po ashtu edhe renditja janë imitim i sures në fjalë, dhe kjo nuk mund të konsiderohet sfidë.

E dyta: Ne thamë më lart se kjo sure plotëson kuptimin e sureve të mëparshme dhe hedh bazat për suret e movonshme, në këtë kuptim anashkalimi i këtyre dy rendeve është nënvlerësim i pjesës më të madhe të hollësive të trajtuara në këtë sure.

E treta: Ekziston një diferencë e madhe mes dy ligjërimeve dhe këtë gjë sigurisht që e vë re kush ka shije të hollë.

Mes gjërave të mprehta që cek kjo sure është edhe fakti se secili prej pabesimtarëve i atribuonte profetit (a.s.) një epitete që nuk ia vinte tjetri. Përshebull dikush shprehej se ai nuk ka trashëgimtar mashkull, ndërsa tjetri se nuk ka përkrahës dhe mbështetës, një tjetër thoshte do t'i shuhet emri, ndërsa Allahu e lavdëroi në atë mënyrë që përfshinte të gjitha virtytet: **“Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira”**, dhe duke mos e kufizuar natyrën e këtyre të mirave të shumta me asgjë nuk ka pse të mos pretendojmë se aty përfshihen mirësitë e dy botëve.

Dhe sa ishte gjallë Zoti e urdhëroi të kryejë të gjitha format e adhurimeve, dhe në fakt adhurimet për nga natyra ndahen në fizike dhe zemre.

Dy janë adhurimet më të rëndësishme fizike; namazi që lidhet me trupin dhe zeqati që lidhet me pasurinë. Adhurimet e zemrës e edukojnë njeriun të mos i dedikojë asnjë adhurim diku tjetër veç Zotit, këtë kuptim ka edhe parafjala ??-li-për, në ajetin **“Për Zotin tënd”**.

Duket se këtu Zoti na tërheq vëmendjen se adhurimet e zemrës nuk mund të realizohen siç duhet pa ato fizike, për këtë arsye përmend adhurimin fizik të parin në ajetin **“dhe falu”** ndërsa parafjala ?-li që përfaqëson adhurimet e zemrës e shoqëron më pas. Kjo është edhe një përgjigje për doktrinën Ibahije [\[1\]](#), e cila pretendon se adhurimi i zemrës është i mjaftueshëm. Pra ??-li në fjalë është dëshmi se pretendimi në fjalë është i pasaktë.

Përmes termit Zot (Rab), Allahu kërkon të tregojë pozitën e lartë të Muhamedit edhe në Botën Tjetër, si të thuash Zoti i thotë Ne u kujdesëm për ty para se të ekzistojë si mund të neglizhojmë përkujdesjen Tonë për ty tani që je i përkushtuar në adhurim?! Dhe ashtu siç del garant në fillim të sures për të mirat

e shumta që i jep Muhamedit, del garant në fund të saj për ta mbrojtur dhe dekonstruktuar akuzat e kundërshtarëve të tij.

Në fund kjo sure është tregues se Zoti si fillim dhuron mirësi me bollëk dhe pastaj i plotëson begatitë në të dy botët.

Zoti e di më mirë të vërtetën!

Përktheu: Dorian Balliu

[1] Një doktrinë e cila pretendon se njeriu është i çliruar nga detyrimet, mjafton të pranojë me zemër ekzistencën e Zotit dhe nuk është fare e nevojshme të kryejë detyrimet e tjera, dhe madje si pasojë e kësaj bindjeje ata kanë të drejtë të bëjnë çfarë të dëshirojnë.

Date Created

13/01/2023

Author

erasmusi